



- [Të Reja](#) [Policia e Shtetit](#) [Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet e policisë](#) [Video](#)
- [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#) [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore të Policisë](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#)
- [Donacione](#) [Rubrika Policimi në Komunitet](#) [Përmbledhja Javore](#) [Për sinjalizimin](#)

Breaking News:

FORMULARËT PËR PRANIM NË POLICINË E SHETITIT

Shëngjin – Vijon megaoperacioni policor i koduar “Tempulli”, 2 shtetas në pranga

DVP Lezhë – Parandalohet një ngjarje e rëndë kriminale, sekuestrohet 1 snajper me fishekë në fole

Tiranë – Shkatërroi traun e parkimit të një hoteli, kundërshtoi punonjësit e Policisë dhe dëmtoi automjetin e tyre ndërkohë që ata u përpoqën ta neutralizonin, vihet në pranga 42-vjeçari

Durrës – U kapën në flagrancë në afërsi të portit të Durrësit, me doza kanabisi, gati për shitje, dhe një mjet prerës (thikë), vihen në pranga 2 shtetas



Lajmet Operacionet

18/12/2023

DVP Lezhë – Parandalohet Një Ngjarje E Rëndë Kriminale, Sekuestrohet 1 Snajper Me Fishekë Në Fole

DVP Lezhë

Parandalohet një ngjarje e rëndë kriminale, falë inteligjencës policore dhe reagimit në kohë të shërbimeve të Policisë.

I armatosur me snajper me fishekë në fole, gati për të kryer vrasje, rrezikoi jetën e punonjësve të Policisë në pikën e kontrollit dhe u largua me shpejtësi, vijon kontrolli i zonës për kapjen e 23-vjeçarit.

Vihet në pranga njëri nga bashkëpunëtorët e tij dhe shpallet në kërkim një tjetër, për sigurim të kushteve dhe mjeteve për kryerjen e një vrasjeje.

Sekuestrohen 1 armë zjarri snajper me precizion të lartë me fishekë në fole gati për qitje dhe një çantë me fishekë për këtë armë.

Falë inteligjencës policore dhe si rezultat i hetimeve të thelluara që po kryhen intensivisht në kuadër të operacionit policor të koduar “Sundimi i ligjit”, për të zbardhur ngjarjet kriminale të ndodhura së fundi dhe për të parandaluar ngjarje të tjera të mundshme kriminale, specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve ndaj Jetës, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin, duke vlerësuar edhe informacionet e siguruara nga inteligjencia policore, kanë parandaluar një ngjarje të mundshme kriminale.

Në mesnatë, në vendin e quajtur “Kryqëzimi i Fushë Kuqes”, Kurbin, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe Forcat e Sigurisë Kombëtare i kanë bërë shenjë ndalimi një automjeti me të cilin dyshohet se po qarkullonte shtetasi që do të kryente vrasje.

Drejtuasi i automjetit, shtetasi O. H., sapo ka parë shërbimet e Policisë, ka rritur shpejtësinë duke rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë dhe në fshatin Gurëz ka braktisur automjetin dhe duke përfitur nga errësira është larguar me shpejtësi.

Gjatë kontrollit në automjet, shërbimet e Policisë gjetën një armë zjarri snajper me precizion të lartë, me një krehër me fishekë në të dhe një çantë me fishekë të tjerë për këtë armë.

Në vijim të veprimeve të thelluara hetimore për këtë rast, u vu në pranga shtetasi M. D., 21 vjeç, banues në fshatin Gurëz, Kurbin, si dhe u shpall në kërkim shtetasi Gj. M., 30 vjeç, banues në Fushë Kuqe, Kurbin, të dyshuar si bashkëpunëtorë të shtetasit O. H., 23 vjeç, banues në fshatin Gurëz, Kurbin (i shpallur në kërkim), për veprat penale “Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit luftarak”.

Forcat e Sigurisë Kombëtare, ato të DVP Lezhë dhe të Komisarariatit të Policisë Kurbin vijnë kontrollin e zonës, për kapjen e shtetasve O. H. dhe Gj. M.

Vijon puna hetimore në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për identifikimin e shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale dhe për dokumentimin e plotë ligjor të saj.

Materialet procedurale iu kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

angazhimpërkushtimsakrificë👮🚓

tëvendosurkundërkrimit✅

nëçdoskajtëvendit🇲🇰

nëshërbimtëqytetarëve👮🤝👤

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Tiranë – Shkatërroi traun e parkimit të një hoteli, kundërshtoi punonjësit e Policisë dhe dëmtoi automjetin e tyre ndërkohë që ata u përpoqën ta neutralizonin, vihet në pranga 42-vjeçari

Shëngjin – Vijon megaoperacioni policor i koduar “Tempulli”, 2 shtetas në pranga ▶